



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001839/6

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Për zgjidhjen e disa problemeve të evidentuara në komunikimin me disa drejtori vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën"

Drejtuar: Z. Artan LAME

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Rr. "Dora D'Istria", nr. 2,
Agjencia Shtetërore e Kadastrës
TIRANË

Për dijeni: Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Z. Engjëll Agaçi – Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 7,
Këshilli i Ministrave
TIRANË

I nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm,

Në kuadër të ushtrimit të detyrave të parashikuara në nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjin nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, Institucioni ynë, ka hasur në pengesa për ushtrimin e detyrës, për shkak të interpretimit që disa prej drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës i kanë bërë Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.389, datë 13.05.2020, "Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale".

Duke qenë se më poshtë do analizojmë përmbajtjen e këtij akti normativ, përfitojmë nga rasti të sjellim në vëmendjen tuaj faktin që ky akt nënligjor, nuk është dërguar për mendim në Institucionin tonë, ndaj nisur nga fakti se akte të tilla, lidhen me një sërë të drejtash dhe detyrimesh të një numri të madh individësh, përfitojmë nga rasti të rekomandojmë që projektakte të tilla, të sillen paraprakisht për mendim edhe në institucionin Avokatit të Popullit.

1. Mosdhënia e informacionit prej disa drejtorive vendore të ASHK-së, institucionit të Avokatit të Popullit, me pretendimin se duhet parapaguar tarifa e përcaktuar në VKM 389, datë 13.05.2019.

Pengesat e konstatuar nga Institucioni ynë, kanë të bëjnë me rastet e disa drejtori vendore, si DVASHK Kukës, DVASHK Tirana-Veri, DVASHK Elbasan (fotokopje të shkresave bashkëngjitur), të cilat duke përmendur si mbështetje ligjore Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.389, datë 13.05.2020 “*Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale*”, nuk përmbushin detyrimin ligjor për dhënien e shpjegimeve Institucionit të Avokatit të Popullit, me pretendimin se duhet parapaguar më parë tarifa e shërbimit, veprim ky që ka penguar veprimtarinë e Institucionit tonë.

Nga analizimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.389, datë 13.05.2020, rezulton, se ky Vendim është nxjerrë në zbatim të pikës 2, të nenit 63, të ligjit nr.111/2018, “*Për kadastrën*”.¹

Duke qenë se ligji “*Për kadastrën*”, nuk e shpjegon në mënyrë specifike togfjalëshin: «*shërbim kadastral*», përdorur në pikën 1 të nenit të VKM-së së mësipërme, në kuptim të ligjit “*Për kadastrën*”, (mbështetur edhe në përkufizimin e nenit 3 pika 1 të këtij ligji)², konsiderohen ato shërbime për të cilat lëshohen aktet kadastrale dhe që lidhen më subjektet e parashikuara nga neni 4 i po këtij ligji.³

¹ Ligji nr.111/2018 “*Për kadastrën*”: *Neni 63 - Tarifat e shërbimit kadastral*

1. *Çdo shërbim kadastral që ofrohet, me përjashtim të rasteve të veçanta, të parashikuara në këtë ligj, tarifohet.*
2. *Lista e shërbimeve kadastrale dhe tarifat për çdo shërbim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*
3. *Për çdo shërbim të përjashtuar nga tarifa, Këshilli i Ministrave vendos për kompensimin e tarifës nga fondet e buxhetit të shtetit.*

² Ligji nr.111/2018 “*Për kadastrën*”: *Neni 3 – Përkufizime*

1. *“Aktet kadastrale” janë dokumentet zyrtare unike që Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon për çdo pronar të pasurive të paluajtshme ose titullar të të drejtave reale mbi to. Këto akte përfshijnë: certifikatat, vërtetimet, ekstrakte të kartelës kadastrale, hartës kadastrale dhe akte të tjera të parashikuara në këtë ligj.*

³ Ligji nr.111/2018 “*Për kadastrën*”: *Neni 4 – Subjektet*

1. *Subjekte, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen pronarët, titullarët e të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, personat fizikë ose juridikë, që kanë interes të ligjshëm mbi pasuritë.*

Gjithashtu, ligji “Për kadastrën”, për marrjen e informacionit (bazuar në parimin e nenit 118, pika 2 të Kushtetutës, sipas të cilit: “2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte”), në nenin 28, pika 6, të tij, ia ka ngarkuar detyrën për përcaktimin e rregullave për marrjen e informacionit Këshillit të Ministrave,⁴ por nga verifikimi që ne kemi bërë, nuk rezulton ende që të jetë miratuar një akt i tillë (për çështjen e mosnxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për kadastrën”, do ndalemi më hollësisht më poshtë.

Pra, nga gjithë sa analizuam më sipër, gjykojmë se në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion dhe shpjegime, ndërmjet Institucionit tonë dhe drejtorive vendore të ASHK-së, jo vetëm nuk bëhet fjalë për të kërkuar shërbime kadastrale, por ndodhemi përpara rasteve të mirëfillta të kërkesave për informacion, të cilat lidhen me përmbushjen ose jo, të detyrës zyrtare nga punonjësit/nëpunësit shtetëror të ASHK-së.

Detyra e Institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive apo interesave të ligjshme të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike; E drejta e informimit; apo E drejta e ofrimit të informacionit pa pagesë për institucionin e Avokatit të Popullit në kuadër të përmbushjes së interesave të ligjshme të individëve; janë të rregulluara nga ligje të ndryshme nga i nr.111/2018 “Për kadastrën”.

Më konkretisht, disa prej dispozitave të këtyre ligjeve parashikojnë sa vijon:

1. Neni 60, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: «Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike», ndërkohë që sipas nenit 63, pika 4, po të Kushtetutës: «Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij».
2. Neni 13, pika 1, e ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon se: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”, ndërkohë që, sipas nenit 16, po të këtij ligji: «Çdo shërbim që bëhet nga Avokati i Popullit lidhur me ankesat, kërkesat e njoftimet është pa pagesë».

Në hierarkinë e akteve të parashikuara në nenin 116 të Kushtetutës, ligji nr.8454, datë 04.02.1999 «Për Avokatin e Popullit», të ndryshuar, prevalon mbi aktin nënligjor VKM-në nr.389, datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, për rrjedhojë, punonjësit/nëpunësit e zyrave vendore të ASHK-së, në mënyrë jo profesionale, nuk përmbushin detyrimin ligjor për dhënie informacioni dhe shpjegimesh institucionit të

⁴ Ligji nr.111/2018 “Për kadastrën”: Neni 28 –Garantimi i aksesit mbi ekstraktet

6. ASHK-ja siguron akses të drejtpërdrejtë në kadastrën digjitale për organet që ushtrojnë ndjekjen penale dhe agjencitë ligjzbatuese. **Këshilli i Ministrave miraton me vendim listën e institucioneve që kanë akses në kadastrën digjitale dhe rregullat e marrjes së informacionit.**

Avokatit të Popullit, duke ju referuar gabimisht VKM nr.389, datë 13.05.2020.

3. Sipas nenit 19 pika 1 e Kodit të Procedurës Administrative: *“Procedura administrative është pa pagesë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe”*.
4. Parimi i marrjes së informacioneve pa pagesë, është parashikuar edhe në ligjin nr.111/2018, *“Për kadastrën”*, ku më konkretisht, në nenin 68 - *Bashkëpunimi ndërinstytucional*, parashikohet se: *“1. ASHK-ja, bashkërendon veprimtarinë me Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e vetëqeverisjes vendore dhe çdo institucion apo strukturë tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet me çështjet e pronësisë. 2. Çdo institucion shtetëror apo ent tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi në realizimin e proceseve, sipas këtij ligji apo ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara, ka për detyrë të bashkëpunojë dhe t'i ofrojë gjithë informacionin e duhur ASHK-së, pa asnjë tarifë.”*

Referuar legjislacioni të lartpërmendur, mendojmë se është e qartë se kërkesa e nëpunësve të ASHK-ve për pagesë tarife, në rastet e administrimit të kërkesave për informacion dhe shpjegime të institucionit të Avokatit të Popullit, është e gabuar.

Ky qëndrim i shfaqur prej disa zyrave vendore të ASHK-së, i cili mund të vijë si rezultat i mosnjohjes, apo zbatimit të gabuar të legjislacionit në fuqi, ose edhe si një mënyrë për të fshehur veprimet, apo mosveprimet e gabuara të tyre, i ngarkon këta nëpunës, të paktën me përgjegjësi administrative.

Në konkluzion të kësaj pike, jemi të mendimit se situata e mësipërme, që pengohet Institucioni i Avokatit të Popullit të ushtrojë rregullisht detyrat e tij, të parashikuara në Kushtetutë dhe ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër kërkojmë ndërhyrjen e menjëhershme, për zgjidhjen e këtij problem, me të gjitha Drejtoritë Vendore të ASHK-së.

2. Marrja dhe dhënia e shërbimeve prej ASHK-së vetëm në rrugë digjitale

Një çështje tjetër që vlerësojmë se duhet ndryshuar në përcaktimet e kryera në VKM nr.389, datë 13.05.2020, është kushtëzimi i kryer në pikën 6, se aplikimet për dhënien e shërbimeve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive vendore të saj, pranohen vetëm në rrugë digjitale on-line, nëpërmjet platformës e-Albania.

Heqja e alternativave të tjera për aplikim, për marrjen e shërbimeve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, nuk është në përputhje as me parashikimet e kryera nga neni 10/2 i Kodit të Procedurës Administrative *“Parimi i dhënies së ndihmës aktive”*, sipas të cilit:

“1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e

lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.

3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit”.

Ne jemi të mendimit se përcaktimi i kryer në pikën 6, të VKM-së nr.389, datë 13.05.2020, nuk duhet vendosur si kusht, për pranimin e kërkesave/aplikimeve vetëm në rrugë digjitale (elektronike), pasi një zbatim i tillë sjell kufizimin e marrjes së shërbimeve pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive vendore të saj, në mënyrë të lehtë dhe efektive.

Sjellim në vëmendje se në kategorinë e subjekteve që kërkojnë marrjen e shërbimeve kadastrale, bëjnë pjesë edhe subjekte të cilët janë të paditur, apo në pamundësi për përdorimin e rrugës digjitale për marrjen e shërbimit pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Për gjithë sa më sipër, detyrimi i shtetasve që të kërkojnë shërbimet në një mënyrë për të cilin ata nuk janë të interesuar ti marrin, përkeqëson të drejtat dhe interesat që subjektet aplikuese gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi, ndaj kërkojmë ndërhyrjen tuaj për zgjidhjen pa vonesë të kësaj çështjeje.

3. Mosnxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

Me hyrjen në fuqi më datë 10.04.2019, të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, Këshilli i Ministrave, në zbatim të parashikimit të nenit 71,⁵ ka pasur detyrimin e nxjerrjes së akteve nënligjore (për çështjet e parashikuara në pikat 1/a dhe 1/b të këtij neni), brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Por edhe pse afati ligjor i vendosur për nxjerrjen e akteve nënligjore ka përfunduar më datë 10.04.2020, konstatohet se përmbushja e këtij detyrimi nuk ka ndodhur.

Mungesa e akteve nënligjore të parashikuara në nenin 71 të ligjit nr.111/2018, “Për Kadastrën”, ndikon negativisht në: zgjidhjen e problemeve për regjistrimin e titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar saktë sipërfaqen, sipas pikës 4, të nenit 30; përcaktimin e elementëve formalë që duhet të përmbajnë aktet noteriale, apo aktet administrative, që hartohen për efekt regjistrimi, sipas këtij ligji.

⁵ 1. Përveç sa parashikohen shprehimisht në dispozita të tjera të këtij ligji, Këshilli i Ministrave përcakton: a. procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar në të sipërfaqen, sipas pikës 4, të nenit 30;

b. elementet formale të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi, sipas këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji

Gjithashtu mungesa e ketyre akteve nënligjore, përveç se nuk respekton detyrimin e vendosur me ligj, mund të bëhet premisë edhe për lindjen e konflikteve të reja, për të cilat nga subjektet privatë, apo edhe shtetërorë, do të kërkohet kohë dhe energji për tu zgjidhur.

Në konkluzion të kësaj pike, Avokati i Popullit nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, si dhe për parandalimin e konflikteve të reja që mund të lindin, kërkon marrjen e masave për zgjidhjen pa vonesë të kësaj çështjeje.

Ne besojmë se zgjidhja e të treja çështjeve të përmendura më sipër, do të ndihmojë gjithashtu edhe për ndërprerjen e situatës së cënimit të parimit «për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor».

Për gjithë arsyet e përmendura më sipër, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet, se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrate publike”*, si dhe parashikimit të kryer në nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*- të ndryshuar, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

1. Rishikimin e qëndrimit të disa drejtorive vendore të ASHK-së, në marrëdhënie me institucionin e Avokatit të Popullit, për çështjet që lidhen me dhënien e informacionit institucionit tonë.
2. Marrjen e masave që ofrimi i shërbimeve prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive vendore të saj, përveç rrugës digjitale on-line, të mundësohet edhe në formë tjetër alternative.
3. Kryerjen e veprimeve konkrete, për të mundësuar nxjerrjen sa më parë të akteve nënligjore, në respektim të detyrimit të parashikuar në ligjin nr.111/2018 *“Për kadastrën”*.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij Rekomandimi, konform parashikimit të kryer në nenin 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* - të ndryshuar, kërkohet që kthimi i përgjigjes të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Me besim në bashkëpunimin tuaj!


ERINDA BALLANCA


